

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Data: 07.07.2022

Numri i vrojtimit të lejes:

07 Nr.387/350-30862

- Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit e Komunës së Suharekës në bazë të kërkesës së zot. Nuhi Llugaxhiu nga Vraniçi, Komuna Suharekë, me 07 Nr.350-30862 të datës 25.05.2022 - në të cilën kërkon dhënjën e lejes për vendosjen e një LED Monitori dhe në bazë të nenit 8 alinea 8.10 pika 8.10.6 dhe 8.10.8 të Rregullores për Tarifat, Ngarkesat dhe Gjobat nga Shërbimet dhe Veprimtarit Komunale - 01 Nr. 16-12102 të datës 01.12.2015 dhe Rregullores - 01 Nr. 16-4719 dt. 30.06.2016 për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike dhe private, lëshon këtë :

PËLQIM

Ky dokument lëshohet për:

Emri:	Nuhi Llugaxhiu	Nr. Personal	
Adresa:	“Prime Led”Shpk. Rr.“Brigada-123” – Suharekë.	Telefoni:	
Email :		Kërkesa Bazë:	Pëlqim - për vendosjen e një LED Monitori në qytetin e Suharekës.

Përshkrimi:

I LEJOHET - investuesit z. **Nuhi Llugaxhiu** - përfaqësues i firmës “Prime Led”Shpk.me seli në Suharekë, Komuna Suharekë, vendosja e një LED Monitori (tabelë-reklamë) në objektin afarist të z. Besnik, Agim dhe Kujtim Kuçi (me të cilët ka bërë kontratë për shfrytëzim të hapsirës për vendosjen e reklamës - sipas Pëlqimit dhe Kontratës së bashkëngjitur kërkesës) në rrugën “Brigada-123“, në ngastrën kadastrale Nr.773-0, vendi i quajtur “Fshat”, në Suharekë, Komuna Suharekë.

Led monitori do të jetë me dimensione – **8.00 m. x 4.00 m.** i përforcuar për objekti sipas projektit ideor, përshkrimit teknik dhe fotos së dorëzuar pran kësaj drejtorie me kërkesën 07 Nr. 350-30862 të dt. 25.05.2022.

Vendosja e Led monitorit është me **karakter të përkohshëm** dhe vlen gjerë më **30.06.2023** - me mundësi të vazhdimit pas shqyrtimit të rrethanave të reja të krijuara dhe dispozitave tjera ligjore .

Për nevoja më të mëdha të realizimit të planit Urbanistik të kësaj pjese të qytetit, ku lejohet vendosja e objektit në fjalë, investuesit edhe para skadimit të afatit të caktuar me këtë Pëlqim mundë të i bihet Aktvendimi për mënjanimin e së njëjtës, pa kurrfarë kompensimi nga ky Organ e në shpenzime të vet investuesit.

Investuesi është i obliguar që më së paku 30 ditë para skadimit të afatit të parashtror kërkesë të re për zgjatjen e afatit të Led monitorit për vitin e ardhshëm .

Për mos kryerje të punëve sipas këtij Pëlqimi , inspekcioni përkatës do të veproj sipas rregullave të parapara me ligj .

Ky Pëlqim pushon të vlejë nëse investuesi nuk e vendos objektin në afat prej 3 muajsh nga dita e lëshuarjes së të njëjtit.

Arsyetim

Pranë Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit të Komunës së Suharekës ka parashtruar kërkesë z. **Nuhi Llugaxhiu** - përfaqësues i firmës “Prime Led”Shpk.me seli në Suharekë, Komuna Suharekë, për vendosjen e një LED Monitori (tabelë-reklamë) në objektin afarist të z. Besnik, Agim dhe Kujtim Kuçi me të cilët ka bërë kontratë për shfrytëzim të hapsirës për vendosjen e reklamës - sipas Pëlqimit dhe Kontratës së bashkëngjitur kërkesës. Në bazë të kërkesës ky organ përmes shërbimit të vetë teknik e pas shqyrtimit të parashtrës dhe shtojcave ka konstatuar se: kërkesa është e arsyeshme dhe se parashtruesit të kërkesës mundë të i jepet leja përkatësisht **Pëlqimi** për vendosjen dhe kryerjen e punimeve të lartë cekura.

Kërkesës iu është bashkangjitur edhe dëshmia mbi pagesën sipas nenit 8 alinea 8.10 pika 8.10.6 dhe 8.10.8 të Rregullores për Tarifat, Ngarkesat dhe Gjobat nga Shërbimet dhe Veprimtarit Komunale - 01 Nr. 16-12102 të datës 01.12.2015.

Gjithashtu kësaj kërkesë i është bashkangjitur edhe dëshmia mbi pagesën e **Pëlqimit** për vendosjen e objektit të përkohshëm konform Rregullores mbi tarifat dhe ngarkesat 01 Nr. 16-12102 të datës 01.12.2015 - sipas nenit 8. pika 8.8.5. - në vlerë prej **15.00** euro.


Udhëzime Juridike : Kundër këtij Pëlqimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese - MMPHI-së Prishtinë, përmes kësaj drejtorie, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të së njëjtit.

Pëlqimi i dërgohet:

-Parashtruesit të kërkesës, Inspektorit Komunal dhe dosjes së DUP-it.

Zyrtari përgjegjës:

Agron Bajraktari



Drejtori i Drejtorisë :
Visar Kuçi

